



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 26, datë 14.10.2020

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “KOMPLEKS TURISTIK
“GONE-PERIVOL”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Concord Investments” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Kompleks Turistik “Gone-Perivol”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Concord Investments” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko – ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.7, datë 11.10.2016 dhe Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.11, datë 12.04.2017 shfuqizohen.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

